



Prishtinë, 24.01.2023

## PËRGJIGJE NË KOMENTET E KEK

### Përmbledhje

Pas raportit fillestar *RAPORT I MONITORIMIT TË SHIT-BLERJES SË ENERGISË ELEKTRIKE NGA GJENERATORI PUBLIK "KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS" (KEK)*, i licencuari ka pasur mundësi të paraqes komentet për një periudhë dy javore.

Gjatë periudhës 2 javore, ZRRE ka pranuar komente nga gjeneratori publik KEK, të cilat i ka analizuar me kujdes dhe ka paraqitur përmes këtij dokumenti propozimet përfundimtare lidhur me monitorimin e shit-blerjes së energjisë elektrike nga gjeneratori publik "Korporata Energjetike e Kosovës" (KEK).

### Komentet e KEK si Përgjigje mbi raportin e monitorimit të ZRRE-së

*Të gjeturat në raportin e ZRRE: Dhënia dhe marrja e energjisë elektrike KEK – KESH*

#### Të gjeturat dhe konstatimet:

1. KEK ka kërkuar energji nga KESH edhe atëherë kur nuk ka pasur nevojë për FSHU dhe energjinë e pranuar nga KESH e ka ofruar në treg të lirë. Një veprim i tillë bie në kundërshtim me Nenin 1 të Marrëveshjes për shkëmbim/depozitim të energjisë elektrike në mes Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK).

#### KOMENTI NGA KEK:

Fillimisht duhet të qartësohet situata, pasi që në disa raste KESH ka kërkuar nga KEK që të depozitoj energjinë në KEK për shkak të kushteve klimatike (të reshurave). Në këtë rast KEK ka ndaluar njësinë gjeneruese për ti dal në ndihmë KESH.

Për më tepër, KESH me datë 1 Maj 2022 ka dërguar kërkesë tek KEK për ti dalur në ndihmë pasi që janë parashikuar reshje të mëdha shiu dhe rreziku nga përmbytjet ka qenë evident. Kërkesa është bazuar në nenin 1 të marrëveshjes së shkëmbimit në mes të KEK dhe KESH.

1. *Ndihmës së ndërsjellë në rast situatash emergjente, përfshirë këtu rastet e avarive dhe kushtet e vështira hidrologjike (prurjet e mëdha që mundë të shkaktojnë katastrofa natyrore si përmbytje, etj) që mundë të cenojnë sigurinë e dy sistemeve elektro-energjetike.*



Në këtë rast KEK i është përgjigjur pozitivisht KESH duke pranuar energjinë elektrike të depozituar kohë më parë nga vet KEK tek KESH, me kapacitet dhe profil të njëjtë me atë të njësisë së ndalur e cila parashihej të ishte në punë sipas bilancit të aprovuar. Në këto rrethana, menaxhimi i energjisë në dispozicion është bërë njësoj sikur njësia në fjale të ishte në punë gjë që parashihej edhe me bilancin e aprovuar.

Bazuar në argumentet e paraqitura më lartë, konsiderojmë që KEK nuk ka vepruar në kundërshtim me marrëveshje.

## **Përgjigje e ZRRE-së**

ZRRE ka kërkuar nga KEK sqarime shtesë lidhur me kërkesën e KESH për t'i dalur në ndihmë për shkak të kushteve klimatike (të reshurave), me ç'rast KEK ka dërguar komunikimin zyrtarë në mes KESH dhe KEK, ku konfirmohet kërkesa e KESH për depozitimin e energjisë elektrike për këtë periudhë. Rrjedhimisht ZRRE konsideron të pranueshëm përgjigjen e KEK.

## *Të gjeturat në raportin e ZRRE: Kontratat kornizë në mes KEK dhe palëve tregtare*

### **Të gjeturat dhe konstatimet:**

- 1. KEK ka nënshkruar Kontrata Kornizë me ndërmarrjet të cilat nuk janë të licencuara në Kosovë, respektivisht nuk i njihet licenca e lëshuar nga vendet përkatëse, sipas parimit të reciprocitetit. Bazuar në këtë të gjetur, KEK nuk ka vepruar në pajtueshmëri me neni 28, par.1 dhe par. 2 dhe neni 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, neni 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, neni 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, neni 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike.**

### **KOMENTI NGA KEK:**

Që nga periudha e nënshkrimit të kontratave EFET GENERAL AGREEMENT me tregtarët dhe pas çdo tregtimi mujor, KEK në vazhdimësi ka njoftuar ZRRE-në (departamentin e Tregut) në baza mujore për energjinë e tregtuar: për sasi, çmimet dhe kompanitë tregtare të cilët kanë realizuar tregtimin me KEK përgjatë muajit. Në pjesën e dytë të vitit 2022, KEK ka shkëmbyer disa komunikime me ZRRE, ku nga kjo e fundit është kërkuar të ndërpresë tregtimin me operator të pa licencuar. Ne, duke u mbështetur në dispozita ligjore mbi bazën e parimit të reciprocitetit ( neni 32 paragrafi 3 i Ligjit për Energji Elektrike ne fuqi 05-L-085 ) përcaktohet se “ 3. Licencat e lëshuara për tregtimin e energjisë elektrike në Palët tjera Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë duhet të njihen në Kosovë. Furnizuesit e tillë të licencuar do të kenë të drejtë të tregtojnë energjinë elektrike pa pasur nevojë për licencë shtesë. Tregtarët dhe furnizuesit e regjistruar në një Palë tjetër të Komunitetit të Energjisë kanë të drejtë të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, sipas parimit të reciprocitetit dhe në përputhje me rregullat e aplikueshme të tregut, rregullat e balancimit dhe rregullat fiskale. KEK ka konsideruar se subjektet me të cilat kemi tregtuar energjinë elektrike, nuk kanë pas nevojë për licencim shtesë duke



vlerësuar se të njëjtit janë të licencuar në shtetet e tyre ku janë themeluar dhe licenca shtesë ka qenë e pa nevojshme dhe se lidhur me tregtimin e energjisë kjo dispozitë mbizotëron cdo dispozite tjetër. Pretendimet tona i kemi paraqitur edhe në shkresën me numër 3982 të datës 27.06.2022 ku janë elaboruar në detaje secili pretendim i yni. Në këto pretendime, ZRRE-ja është përgjigjur me shkresën nr. 363/22 të datës 15.07.2022, ku ka theksuar se “bazuar ne legjislacionin ne fuqi, aktiviteti i furnizimit dhe tregtimit me energji elektrike mund te ushtrohen vetëm me Licence te lëshuar nga ZRRE për subjektet juridike qe janë te regjistruara në Kosovë dhe se parimi i reciprocitetit për njohje licencash nuk mund të pretendohet për shkakun se Sekretariati i Komunitetit te Energjisë (SKE) ka iniciuar procesin e pranimit reciprok te Licencave te tregtimit me energji elektrike brenda shteteve anëtare te Komunitetit te Energjisë, por Vendimi i hartuar nga SKE nuk është aprovuar nga Këshilli i Ministrave (KE) te Komunitetit te Energjisë”. Gjithashtu, në këtë shkresë ZRRE-ja ka theksuar se “Duke u bazuar ne parimin e Reciprocitetit ZRRE dhe Enti Rregullator i Energjisë ne Shqipëri (ERE), ne dhjetor te vitit 2021 kane lidhur Marrëveshje Mirëkuptimi për njohjen reciproke te Licencave për Furnizim dhe Tregti me energji elektrike, dhe si rezultat i kësaj marrëveshje janë disa Licenca te lëshuar ne Shqipëri te cilat janë pranuar edhe ne Kosove”. Pavarësisht argumentimeve të cilët i kemi shkëmbyer me ZRRE-në, KEK konsideron se ka vepruarne pajtim me ligjin për energjin elektrike neni 32. 3 por gjithashtu KEK gjithashtu ka marrë në konsideratë situatën e rënduar energjetike dhe tregtimi me numër më të madh të tregtarëve potencialisht do të siguronte çmimet më të favorshme për KEK-un dhe mundësi më të mëdha për realizimin e tregtimit. Veprimet e KEK për këtë çështje kanë pas qëllim mbrojtën e interesit të përgjithshëm, ngritje e transparencës dhe konkurrencës mbi bazën e mos diskriminimit ne rrethanat e krizës energjetike e cila ka prekur çdo vend në Evrope me theks në rajon. Gjithashtu fakt shtese siq kemi potencuar edhe ne shkres eshte se tregtimi kryhet jashtë kufirit me Kosovën, ( XME- XMK). Ndërsa nëse ZRRE pretendon qe te perdore argumentet nga Ligji per rregullatorin, atëherë për zbatimin e tij sipas vlerësimit te vet duhet te kërkoj nga ana e tregtareve qe te përmbushin kushtet te cilat ZRRE pretendon, përderisa KEK ka pasur mundësi dhe ka zbatuar ligjin e energjisë elektrike për tregtimin e tepricave konform nenit 32.3.

## **Përgjigje e ZRRE-së**

ZRRE konsideron se nuk janë relevante arsyetimet e dhëna nga KEK lidhur me tregtimin e energjisë elektrike me tregtarë të pa licencuar në Kosovë, apo me njohje reciproke sipas kërkesave ligjore.

Prandaj ZRRE rikujton KEK-un se bazuar në legjislacionin në fuqi, aktiviteti i furnizimit dhe tregtimit me energji elektrike mund të ushtrohen vetëm me Licencë të lëshuar nga ZRRE për subjektet juridike që janë të regjistruara në Kosovë, duke përfshirë edhe mundësinë që sipas parimit të reciprocitetit këto aktivitete të lejohen edhe pa Licencat e ZRRE-së për tregtarët të cilët kanë licenca në shtetet e tyre, e të cilat mund të njihen në Kosovë vetëm pasi të plotësohen kushtet e



përcaktuara në Rregullën për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës nr 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Gjithashtu, KOSTT, në dhjetor të vitit 2020, pas nënshkrimit të marrëveshjes së kyçjes me ENTSO-E, i'u është drejtuar me email të gjitha palëve tregtare që operojnë në Kosovë, duke kërkuar nga ta që të licencohen konform legjislacionit në fuqi.

Nga këto që u thanë më lartë, ZRRE rithekson se KEK nuk ka ofruar argumente relevante për t'i kundërshtuar të gjeturat në Raportin e ZRRE-së, andaj "KEK nuk ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 28, par.1 dhe par. 2 dhe nenin 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, nenin 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, nenin 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, nenin 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike".

### *Të gjeturat në raportin e ZRRE: Shitja e energjisë elektrike përmes ankandeve të organizuara nga KEK*

#### **Të gjeturat dhe konstatimet:**

1. KEK nuk e ka të aprovuar procedurën e brendshme të bazuar në funksionin e tyre në treg. Bazuar në këtë, tregtimi i energjisë elektrike pa procedurë të brendshme është në kundërshtim me nenin 2, par. 2 i Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. KEK ka përsëritur procesin e shtijes së energjisë elektrike edhe në raste kur ka pasur oferta Valide. Një veprim i tillë nga KEK është në kundërshtim me nenin 13, par. 1 i Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike.
3. KEK gjatë përzgjedhjes së ofertave fituese nuk ka përdorur standard të njëjtë të përzgjedhjes në të gjitha rastet. Bazuar në këtë, përzgjedhja e ofertave fituese nuk është bërë në pajtim me nenin 11 par. 10 dhe nenin 12 par. 1 dhe 3 të Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike.
4. Me nënshkrimin e kontratave individuale me ndërmarrjet, degët e të cilave nuk janë të licencuara në Kosovë, KEK nuk ka vepruar në pajtueshmëri me neni 28, par.1 dhe par. 2 dhe neni 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, neni 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, neni 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, neni 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike.

#### **PËRGJIGJE NGA KEK:**

Pika 1.

Lidhur me te gjeturën nr.1 e cila ndërlidhet me procedurën e brendshme për tregtim te energjisë, vlenë të theksohet (ashtu siç është prezantuar nga stafi i KEK përgjatë procesit të monitorimit nga ZRRE-ja në zyrat e KEK-ut), KEK që nga periudha Tetor 2020 ka hartuar procedurën e brendshme për shit-blerje të energjisë elektrike. Në të njëjtën periudhë është adresuar tek Bordi për aprovim por që të njëjtën procedurë me disa komente e kanë adresu për mbledhje të radhës së bordit. Mirëpo, duke marrë në konsideratë që përgjatë periudhës 2020 – 2022 KEK është ballafaquar me ndryshime të shpeshta të Menaxhmenteve por edhe Bordeve, atëherë kjo procedurë nuk ka arritur të futet në rend dite dhe të aprovohet ende. Mirëpo, zotohemi që kjo procedurë pritet të



aprovohet përgjatë tremujorit të parë të vitit 2023. Theksojmë se, pavarësisht se e njëjta nuk është aprovuar ende, procesi i tregtimit është bazuar në këtë draft procedurë.

Pika 2.

Gjatë procesit të tregtimit të energjisë elektrike për shkak të ngarkesës dhe presionit të madh që transaksionet përkatëse të rezultojnë me kushtet më të favorshme, ka mundur të ndodhë që nga pakujdesia të ketë edhe lëshime teknike. Ne çfarëdo rasti ishin ndërmarr masa korrigjues që lëshimet e mundshme të mos ndodhin tutje nga ajo kohe.

Pika 3.

Stafi i KEK i cili merret me tregtimin e energjisë elektrike kryesisht ka qenë i përkushtuar që të përdoren standardet e njëjta dhe në përputhje me Procedurën për tregtimin e energjisë elektrike të miratuar nga ZRRE-ja. Vlenë të theksohet se stafi i këtij departamenti së ne ate kohe kishte filluar aktivitetin e tregtimit dhe ishin në zhvillim e sipër. Ne çfarëdo rasti ishin ndërmarr masa korrigjues që lëshimet e mundshme të mos ndodhin tutje nga ajo kohe

Pika 4.

#### **PËRGJIGJE NGA KEK:**

Që nga periudha e nënshkrimit të kontratave EFET GENERAL AGREEMENT me tregtarët dhe pas çdo tregtimi mujor, KEK në vazhdimësi ka njoftuar ZRRE-në (departamentin e Tregut) në baza mujore për energjinë e tregtuar: për sasi, çmimet dhe kompanitë tregtare të cilët kanë realizuar tregtimin me KEK përgjatë muajit.

Në pjesën e dytë të vitit 2022, KEK ka shkëmbyer disa komunikime me ZRRE, ku nga kjo e fundit është kërkuar të ndërpresë tregtimin me operator të pa licencuar. Ne, duke u mbështetur në dispozita ligjore mbi bazën e parimit të reciprocitetit ( neni 32 paragrafi 3 i Ligjit për Energji Elektrike ne fuqi 05-L-085 ) përcaktohet se “ 3. Licencat e lëshuara për tregtimin e energjisë elektrike në Palët tjera Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë **duhet të njihen në Kosovë**. Furnizuesit e tillë të licencuar do të kenë të drejtë të tregtojnë energjinë elektrike **pa pasur nevojë për licencë shtesë**. Tregtarët dhe furnizuesit e regjistruar në një Palë tjetër të Komunitetit të Energjisë kanë të drejtë të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, sipas parimit të reciprocitetit dhe në përputhje me rregullat e aplikueshme të tregut, rregullat e balancimit dhe rregullat fiskale. KEK ka konsideruar se subjektet me të cilat kemi tregtuar energjinë elektrike, nuk kanë pas nevojë për licencim shtesë duke vlerësuar se të njëjtit janë të licencuar në shtetet e tyre ku janë themeluar dhe licenca shtesë ka qenë e pa nevojshme dhe se lidhur me tregtimin e energjisë kjo dispozitë mbizotëron cdo dispozite tjetër. Pretendimet tona i kemi paraqitur edhe në shkresën me numër 3982 të datës 27.06.2022 ku janë elaboruar në detaje secili pretendim i yni. Në këto pretendime, ZRRE-ja është përgjigjur me shkresën nr. 363/22 të datës 15.07.2022, ku ka theksuar se “bazuar ne legjislacionin ne fuqi, aktiviteti i furnizimit dhe tregtimit me energji elektrike mund të ushtrohen vetëm me Licence të lëshuar nga ZRRE për subjektet juridike që janë të regjistruara në Kosovë dhe se parimi i reciprocitetit për njohje licencash nuk mund të pretendohet për shkakun se Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE) ka iniciuar procesin e pranimit reciprok të Licencave të tregtimit me energji elektrike brenda shteteve anëtare të Komunitetit të Energjisë, por Vendimi i hartuar nga SKE nuk është aprovuar nga Këshilli i Ministrave (KE) të Komunitetit të Energjisë”. Gjithashtu, në këtë shkresë ZRRE-ja ka theksuar se “Duke u bazuar ne parimin e Reciprocitetit ZRRE dhe Enti Rregullator i Energjisë ne Shqipëri (ERE), ne dhjetor të vitit 2021 kane lidhur Marrëveshje Mirëkuptimi për njohjen reciproke të Licencave për Furnizim dhe Tregti me energji elektrike, dhe si rezultat i kësaj marrëveshje janë disa Licenca të lëshuar ne Shqipëri të cilat janë pranuar edhe ne Kosove”.

Pavarësisht argumentimeve të cilët i kemi shkëmbyer me ZRRE-në, KEK konsideron se ka vepruarne pajtim me ligjin për energjin elektrike neni 32. 3 por gjithashtu KEK gjithashtu ka marrë



në konsideratë situatën e rënduar energjetike dhe tregtimi me numër më të madh të tregtarëve potencialisht do të sigurote çmimet më të favorshme për KEK-un dhe mundësi më të mëdha për realizimin e tregtimit. Veprimet e KEK për këtë çështje kanë pas qëllim mbrojtën e interesit të përgjithshëm, ngritje e transparencës dhe konkurrencës mbi bazën e mos diskriminimit në rrethanat e krizës energjetike e cila ka prekur çdo vend në Evropë me theks në rajon.

Gjithashtu fakt shtese siq kemi potencuar edhe në shkres është se tregtimi kryhet jashtë kufirit me Kosovën, ( XME- XMK).

Ndërsa nëse ZRRE pretendon që të perdore argumentet nga Ligji për rregullatorin, atëherë për zbatimin e tij sipas vlerësimit të vet duhet të kërkoj nga ana e tregtareve që të përmbushin kushtet të cilat ZRRE pretendon, përderisa KEK ka pasur mundësi dhe ka zbatuar ligjin e energjisë elektrike për tregtimin e tepërçave konform nenit 32.3.

## **Përgjigje e ZRRE-së**

Pika 1.

ZRRE e vlerëson angazhimin e KEK lidhur me përgatitjen e Procedurës së brendshme për tregtim të energjisë elektrike, megjithatë, ashtu siç është gjetur në Raportin e ZRRE-së, dhe konfirmuar nga KEK me përgjigjet e dhëna me shkrim, KEK aktualisht nuk ka të aprovuar këtë procedurë, prandaj ZRRE rithekson se tregtimi i energjisë elektrike pa procedurë të brendshme është në kundërshtim me nenin 2, par. 2 i Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike.

Pika 2.

Në përgjigjen e KEK konfirmohet shkelja e evidentuar nga ZRRE lidhur me përsëritjen e procesit të shtijes së energjisë elektrike edhe në raste kur ka pasur oferta valide, prandaj ZRRE mbetet në qëndrimet e shprehura në Raportin e monitorimit se një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 13, par. 1 i Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike.

Pika 3.

Në përgjigjen e KEK konfirmohet shkelja e evidentuar nga ZRRE lidhur me mos përdorimin e standardit të njëjtë të përzgjedhjes së ofertave fituese në të gjitha rastet, prandaj ZRRE mbetet në qëndrimet e shprehura në Raportin e monitorimit se përzgjedhja e ofertave fituese nuk është bërë në pajtim me nenin 11 par. 10 dhe nenin 12 par. 1 dhe 3 të Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike.

Pika 4.

ZRRE konsideron se nuk janë relevante arsyetimet e dhëna nga KEK lidhur me tregtimin e energjisë elektrike me tregtarë, degët e të cilave nuk janë të licencuara në Kosovë, apo me njohje reciproke sipas kërkesave ligjore.

Prandaj ZRRE rikujton KEK-un se bazuar në legjislacionin në fuqi, aktiviteti i furnizimit dhe tregtimit me energji elektrike mund të ushtrohen vetëm me Licencë të lëshuar nga ZRRE për subjektet juridike që janë të regjistruara në Kosovë, duke përfshirë edhe mundësinë që sipas parimit të reciprocitetit këto aktivitete të lejohen edhe pa Licencat e ZRRE-së për tregtarët të cilët kanë licenca në shtetet e tyre, e të cilat mund të njihen në Kosovë vetëm pasi të plotësohen kushtet e përcaktuara në Rregullën për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës nr 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Gjithashtu, KOSTT, në dhjetor të vitit 2020, pas nënshkrimit të marrëveshjes së kyçjes me ENTSO-E, i'u është drejtuar me email të gjitha palëve tregtare që operojnë në Kosovë, duke kërkuar nga ta që të licencohen konform legjislacionit në fuqi.



Nga këto që u thanë më lartë, ZRRE rithekson se KEK nuk ka ofruar argumente relevante për t'i kundërshtuar të gjeturat në Raportin e ZRRE-së, andaj "KEK nuk ka vepruar në pajtueshmëri me neni 28, par.1 dhe par. 2 dhe neni 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, neni 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, neni 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, neni 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike".

## Raporti ZRRE: Shitja e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të veriut

### Të gjeturat dhe konstatimet:

1. KEK i shet energji elektrike KOSTT për mbulimin e humbjeve në Veri të vendit, nën kushtet e marrëveshjes për mbulimin e humbjeve të sistemit. Shitja e energjisë elektrike tek KOSTT për mbulimin e humbjeve në Veri bie në kundërshtim me procedurën e tregtimit të energjisë elektrike, pasi që në procedurë përcaktohet që tregtimi i energjisë elektrike duhet të i nënshtrohet tregut të lire dhe konkurrues.

### **PËRGJIGJE NGA KEK:**

KEK fillimisht pas vendimit V\_909\_2017 të ZRRE-së dhe de rregullimit të çmimeve të KEK, ka realizuar një marrëveshje për furnizim me energji elektrike ndërmjet KEK dhe KOSTT. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje KOSTT është furnizuar me energji elektrike për mbulimin e humbjeve teknike dhe atyre për veri. Ndërkohë, pas vendimit të Gjykatës kompetente për pezullim (mos mbulimin e humbjeve të veriut me tarifat e konsumatorëve) ky aktivitet është ndërprerë nga të dyja palët. Duke marrë në konsideratë situatën e krijuar me devijimet të KOSTT dhe reagimet e ENTSO-e karshi KOSTT dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, me anë të një vendimi të ish-Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Haradinaj, i është lejuar KOSTT-it që të marrë energjinë e KEK-ut (Tepriçat) për ti minimizuar devijimet e sistemit për shkak të humbjeve në veri. Në lidhje me këtë, atëherë kur është vë në rrezik rrjeti transmetues me devijimet përkatëse, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte ndarë mjete financiare për KOSTT për të mbuluar humbjet në këtë pjesë të Kosovës me qëllim të eliminimit të devijimeve në sistem. Në këtë rast KEK ka vepruar në parimin e marrëveshjes dypalëshe me KOSTT pasi që bëhet fjalë për humbje që i shkaktohen KOSTT dhe me qëllimin që ti dilet në ndihmë në situatën e krijuar pas pavarësimit të KOSTT dhe anëtarësimit në rrjetin e transmetuesve evropian.

**Vlenë të theksohet se përgjatë procesit të monitorimit KEK është informuar nga ZRRE-ja që ky aktivitet nuk është në harmoni me procedurën e tregtimit, atëherë KEK nga muaji Gusht 2022 ka ndërprerë furnizimin e KOSTT me energji për mbulimin e humbjeve të Veriut.**

### **Përgjigje e ZRRE-së**

KEK nuk ka ofruar argumente në të gjeturën e raportit, meqë shkresën në të cilën i'u është referuar KEK, thuhet: "për më tepër tani po ju drejtohem me kërkesë për shqyrtimin e mundësisë për realizimin e programit të kompensimit të Kosovës – kthimit të borxhit nga regjioni, pra kthimit të energjisë së tërhequr për gjatë muajve dhjetor 2017, janar dhe shkurt 2018". Nga kjo shihet se shkresa që është referuar KEK nuk ka të bëjë me energjinë për mbulimin e humbjeve në veri të vendit, por me kthimin e energjisë së tërhequr nga interkoneksioni përmes programit të kompensimit. Për më tepër, pjesa e marrëveshjes mes palëve që ka të bëjë me humbjet e sistemit, pas Aktvendimit të Gjykatës kompetente, nuk duhet të vlej dhe palët nuk



mund ta shfrytëzojnë një marrëveshje për humbje të sistemit për të tregtuar energji për pjesën veriore të vendit.

## *Raporti ZRRE: Shitja e energjisë elektrike për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit (FMF)*

### **Të gjeturat dhe konstatimet:**

- 1. KEK – gjenerimi ka nënshkruar marrëveshje për shitje të energjisë elektrike me KEK – Furnizuesin, duke mos ju nënshtruar kushteve të konkurrencës dhe procedurave të tenderimit. Bazuar në këtë, nënshkrimi i kontratës për shit-blerje të energjisë elektrike në këtë mënyrë, bie në kundërshtim me nenin 22, par.5 të Ligjit për Energji Elektrike.**

### **PËRGJIGJE NGA KEK:**

Fillimisht duhet të merret për bazë afati kohor tepër i shkurtër për faktin që ZRRE-ja ka marrë vendim për fillimin e aktivitetit si Furnizues i Mundësisë së Fundit (KEK) me efekt të menjëhershëm (sot për nesër) pa vullnetin dhe dëshirën e KEK-ut të merret me këtë aktivitet. Duke mos pas kohë të mjaftueshme që KEK Furnizimi të përgatitet për realizimin e të gjitha aktiviteteve të nevojshme për realizimin e këtij detyrimit, atëherë ka parë si mundësi të vetme për kohën në dispozicion që furnizimin e konsumatorit ta realizoj nëpërmjet energjisë elektrike nga KEK Gjenerimi.

Momenti kur KEK është obliguar që të mbulojë furnizimin me energji elektrike si Furnizues i Mundësisë së Fundit dhe duke marrë në konsideratë që ka qenë vetëm një konsumator me konsum me të vogël se 2 MWh, KEK ka vlerësuar se nuk do të ishte problem nëse realizohet furnizimi me në këtë format. Mirëpo, marrë në konsideratë që **pas reagimit të ZRRE-së që ky aktivitet nuk është në harmoni me procedurën e tregtimit të energjisë elektrike dhe nuk i është nënshtruar konkurrencës, atëherë KEK në mënyrë të menjëhershme ka ndërprerë këtë aktivitet me KEK Furnizimin dhe njëkohësisht ka njoftuar ZRRE-në për këtë veprim.**

### **Përgjigje e ZRRE-së**

Bazuar në përgjigjen e KEK lidhur me këtë të gjetur, KEK pranon këtë shkelje duke u arsyetuar për afatin shumë të shkurtër të obligimit të dhënë nga ZRRE për fillimin e aktivitetit të FMF. Pas reagimit të rregullatorit, KEK ka ndërmarr veprimet e menjëhershme për ndërprerjen e këtij aktiviteti.

Bazuar në konstatimet e cekura më lartë, I PROPOZIJMË Bordit të ZRRE-së, që pas vlerësimit dhe analizimit të materialit të bashkangjitur, të konstatoj se ka bazë të mjaftueshme për aplikimin e dispozitave ndëshkimore të përcaktuara me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe dispozitat e Rregullës për Masat Administrative dhe Gjobat.

Kjo duhet të bëhet pas që ti jepet mundësia e fundit KEK, ku ZRRE duhet të lëshoj NJOFTIM me shkrim me të cilin njofton palën, se mund të përgjigjet me shkrim për shkeljet e gjetura brenda katërmëdhjetë (14) ditësh pas dërgimit të njoftimit.